



“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit, pyjeve, ujërave dhe peshkimit në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritit të vendit në Bashkimin Europian. Përbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqënie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik”.

BULETINI MJEDISOR SHKURT 2010

VENDEME & NJOFTIME

Në mbledhjen e datës 01.02.2010, Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për leje mjedisore, mori këto vendime si më poshtë :

QKL/Kod	Lloji i aktivitetit të propozuar	Institucioni / Kompania / Enti që e ka paraqitur	Vendi ku propozohet të zhvillohet aktiviteti	Vendimi
LC-1824-01-2010	EAGLE MOBILE Sh.a.	Durmus Ali Taskin	Antene	Miratohet.
LC-1835-01-2010	INFO METAL PLAST - AL Sh.p.k.	Besnik Istrefi	Minier nikel-silikati	Miratohet.
LC-1713-12-2009	"DEJVIS - B.A." Sh.p.k.	Besnik Allamani	Nyje fraksionim inertesh	Nuk miratohet.
LC-1970-01-2010	BLUMAR SKELE sh.p.k	Salvatore Costanzo	Karriere Guri Gelqeror	Miratohet.
LC-1981-01-2010	RRUNJA Sh.p.k.	Remzi Pupli	Miniere kromi	Miratohet.
LC-1986-01-2010	EGI-K Sh.p.k.	Eduart KETA	Minier Kromi	Miratohet.
LC-1678-12-2009	MERIDA Sh.a.	Halil Lloshi	Depozita karburanti me shumice	Miratohet.
LC-1341-11-2009	Hydroenergy	Skender Zela	Hidrocentral	Miratohet
LC-1643-12-2009	Gener 2 sh.p.k	Bashkim Ulaj	Karriere Guri Gelqeror	Miratohet

Në mbledhjen e datës 22.02.2010, Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për leje mjedisore, mori këto vendime si më poshtë :

QKL/Kod	Aktiviteti	Shoqeria	Vendodhja	Vendimi
LC-2225-02-2010	Kantier per prodhim inertesh betoni dhe asfalti (siperfaqja e kantierit 3350 m2)	"PAKO" shpk	Shkoder/Juban	Miratohet
LC-2150-02-2010	Prodhim pijesh alkolike 30 kv/24h	"AQUILA LIQUORI" shpk	Tirane/autostrate	Miratohet
LC-2127-02-2010	Vendgrumbullimi i inerteve të germimit të skarpates së rruges Rreshen - Kalimash	DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE	Lezhe/Mirdite	Miratohet
LC-2114-02-2010	Vendgrumbullimi i inerteve të germimit të skarpates së rruges Rreshen - Kalimash	DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE	Lezhe/Mirdite	Miratohet
LC-1907-01-2010	Riciklim vajrash lubrifikante të perdorura/20- 100t/dite	AM – OIL shpk	Lushnje/Ish fabrika plasmasit	Të verifikohet ne vend lidhur me teknologjine që perdor. Të shtyhet

Nr. Ceshtjes tek QKL	Lloji i aktivitetit te propozuar	Institucioni / Kompania / Enti qe e ka paraqitur	Vendi ku propozohet te zhvillohet aktiviteti	Vendimi
LC-335	Magazine per plehra kimike, produkte te mbrojtjes se bimeve dhe farerave --1 275 m2	“AGRO BLEND” Sh.p.k.	Fshati Shtodher, Helmes, Rrogozhine, Tirane	Miratohet
LC-2241	Rikonstruksion Rruge -- 9.3 km	Keshilli i Qarkut Korce	Rruga Korite-Zvezde (Liqenas), Komuna Pojan	Miratohet

LAJME & AKTIVITETE MJEDISORE

DITA BOTERORE E LIGATINAVE

2 Shkurti është Dita Botërore e Ligatinave. Tema e shpallur për vitin 2010, **“Kujdesi për Ligatinat –një përgjigje ndaj ndryshimit klimatik”**, ka vendosur theksin mbi kujdesin që duhet treguar nga të gjithë aktorët për të menaxhuar sa më mirë këto ekosisteme në kuadër të ndryshimeve klimatike. Megjithëse ligatinat mbulojnë vetëm 6% të sipërfaqes tokësore të Planetit, ato mbajnë rreth 35% të karbonit tokësor global.

Dita Botërore e Ligatinave, është një ditë globale mjedisore e përcaktuar në kuadër të të Konventës Ramsar për Ligatinat, mbajtur në Iran,1971. Misioni i Konventës është konservimi i të gjitha ligatinave nëpërmjet bashkëpunimeve lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, si një kontribut drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Parku i Prespës u themelua në vitin 2000 me deklaratën e tre kryeministrave të Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë. Në Shqipëri vëmendje e veçantë është treguar dhe tre Ligatinave me rëndësi ndërkombëtare të përcaktuara në Konventën Ramsar (Liqeni i Butrinit,Ligatina e Karavastase dhe Kompleksi Liganitor i Liqenit te Shkodrës dhe Lumit Buna.

TRE MINISTRAT E MJEDISIT NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJEN PËR PARKUN E PRESPËS.

Në ditën Botërore të Ligatinave, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, z. Fatmir Mediu, së bashku me homologët e tij, Ministren Greke, znj. Konstantina Birbili, ministrin Maqedonas, z. Nexhati Jakupi dhe Komisionerit Europian z. Stavros Dimas nënshkruan në 10 vjetorin e krijimit të Parkut të Prespës dhe në ditën ndërkombëtare të Ligatinave, marrëveshjen mbi mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Parkut të Prespës.

Ministri Mediu e quajti firmosjen e kësaj marrëveshje një detyrim të përbashkët, ku bashkëpunimi mes palëve tashmë është një përgjegjësi për zhvillimin e parkut ndërkombëtar të Prespës.

Komisioneri i BE për çështjet e mjedisit, z. Stavros Dimas, theksoi në fjalën e tij se “Hartimi I këtij dokumenti ishte nisëm e vullnetit të mirë të tre kryeministrave në takimin e mëparshëm, gjithashtu dhe pritshmëria për antarësim në BE, i Maqedonisë dhe Shqipërisë, i jep kësaj marrëveshjeje një hapësirë europiane, që rezultatet mos të jenë më të kufizuara. Kjo marrëveshje është në të njëjtën frymë me BE për mbrojtjen e mjedisit, faunës

dhe florës. Objektivi kryesorë i kësaj marrveshje është mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i ekosistemit të Prespës. Në këtë kuadër është mjaft e rëndësishme përmirësimi i kushteve të ujërave të Prespës. Rëndësia e ruajtjes së bimëve e kafshëve të këtij parku e shumë të tjera të ndjekura nga vullneti i mirë i të tëra palëve. Mjaft i rëndësishëm është fakti që në këtë proces është parashikuar edhe pjesëmarrja e të gjitha palëve që janë pushteti qendror, pushteti local dhe shoqëria civile”, u shpreh z. Dimas.

Në fjalën e tij, Ministri Mediu, theksoi prioritetet e Qeverisë Shqiptare për mbrojtjen e zonave të mbrojtura, mbështetjen e shoqërisë civile, ligjin për mbrojtjen e zonave ndërkufitare si dhe sigurimin e rentabilitetit të pyjeve dhe kullotave.

“Një erë e re mardhënie, u firmos sot nga të treja vendet tona. Kjo i jep prioritet integritetit të Prespës. E rëndësishme në këtë marrëveshje të firmosur, është jo vetëm veprimi në planin politik, por që vendimmarrja jonë, financimet të kenë transparencë dhe mbështetje nga shoqëria civile.” – tha Mediu

Gjithashtu, ministri Mediu i kërkoi Ministres Greke, si pjesë e Bashkimit Europian që të jetë promotori i përcjelljes së problemeve të ekosistemit në këtë zonë.

Nga ana e saj, Znj. Bilbili tha se:

“Sot në Prespë nënshkruhet marrëveshja, e cila pritet të konfirmohet nga parlamentet përkatës për ta kthyer në konventë. Kjo përbën një kuadër obligues për të tërë ne, si edhe pjesëmarrja e përfaqësuesit të Komisionit Europian, na bën të ndihemi në rrugën e duhur. Tashmë Ministria Greke e Mjedisit, ka filluar investimet e para nga financimet e BE për mirmenaxhimin e këtij parku, si dhe ka mundur të garantimin e ndihmës për vendet fqinje”

Edhe Ministri Maqedonas, z.Jakupi, e cilësoi këtë marrëveshje mjaft të rëndësishme për zonën. “Mbrojtja dhe zhvillimi i mjedisit, do të ketë impakt të dukshëm edhe në zhvillimin ekonomik të kësaj zone. Qeveritë tona – tha ai, do të gjejnë mjetet e duhura, duke vlerësuar mundësitë e financimit të nevojshëm me qëllim që në praktikë të zbatohet cdo pikë e shkruar e marrëveshjes”.

Marrëveshja e nënshkruar nga 3 ministrat e rajonit dhe Komisionerit Europian, ka si qëllim mbrojtje dhe zhvillimin e Ekosistemit në parkun e Prespës, si bazë për mbështetjen dhe zhvillimin e kësaj zone, duke iu nënshtruar të gjitha parametrave të bashkimit Europian.

KRIJOHET KUALICIONI KOMBËTAR I MJEDISIT

Me 17 shkurt 2010, u mbledh Tryeza Kombëtare për Ngritjen e Kualicionit Kombëtar të Mjedisit. Në këtë takim të parë të këtij Kualicioni Kombëtar Mjedisit, 64 pjesmarrës nënshkruan një Memorandum Mirekuptimi, i cili ishte shprehje e vullnetit të përbashkët për të sjellë në këtë tryezë diskutimin e çështjeve për zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm.

Të pranishëm në këtë eveniment ishte Ambasador i hollandës në Shqipëri Z. Henk-Vanden Dool, deputetë të spektrit politik të djathtë dhe të majtë të politikës shqiptare, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të biznesit dhe të medias.

Zoti Henk van den Dool, në fjalën e tij falenderoi përkushtimin e Institutit të Kërkimeve Urbane si dhe mbështetjen e Ministrisë të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave z. Mediu për angazhimin serioze për krijimin e këtij kualicioni. Duke i ofruar kështu Shqipërisë emancipimin e munguar deri më sot për t'u bërë lobuese, për çështje që qëndrojnë mbi bindjet politike, përkatësive fetare apo ato gjinore.

Z. Taulant Bino në fjalën e tij shprehu kënaqsinë që shoqëria shqiptare po arrin pjekurinë e duhur për të krijuar kualicione, që do të influencojnë (lobbying) dhe do të mbrojnë (advocating) një çështje kaq të rëndësishme sa po bëhet sot çështja e mjedisit.

Nga të pranishmit që mbajtën fjalën u theksua se adresimi i çështjeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit, kërkon zhvillimin dhe zbatimin e politikave të integruara dhe afatgjata në nivelin lokal dhe kombëtar. Nga vetë natyra komplekse e zhvillimit të qëndrueshëm, kërkohet përfshirje e shumë institucioneve qeveritare, bizneseve, shoqërisë civile dhe publikut në tërësi për të mundur arritjen e qëllimeve tona të përbashkëta "Për një mjedis të standarteve Europiane".

KONTROLLE TË VAZHDUESHME PËR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT MJEDISOR

Një nga prioritetet kryesore të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave është zbatimi i legjislacionit mjedisit. Ndaj Drejtoria e Kontrollit të Mjedisit në Lumin Shkumbin ka kontrolluar në mënyrë periodike të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit dhe fraksionimit të inerteve. Gjatë këtij kontrolli është vënë re se një pjesë e madhe e tyre janë pa leje mjedisore, dhe pa leje shfrytëzimi nga Autoritetet e Ujit, mbasi Lumi Shkumbin në bazë të Vendimit të KKKU, nr 1, datë 21.06.2006 "Për reduktimin e shfrytëzimit të zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve", në segmentin nga Rrogozhina deri në grykëderdhje është zonë e ndaluar dhe nuk lejohet të shfrytëzohet. Nga kontrolli u konstatua se në

impiantet e fraksionimit të inerteve, subjektet kanë gjendje sasira të mëdha inertesh lumore dhe nuk kanë bërë çmontimin e makinerive dhe heqjen e materialit sikurse është përcaktuar në Vendimin e K KU, nr 1, datë 21.06.2006.

Ndaj subjekteve të kontrolluara që shfrytëzojnë dhe fraksionojnë inerte në lumin Shkumbin nga Inspektorati i Mjedisit u morën sanksionet e mëposhtme :

1. Xhihani, sh.p.k, 2 000 000 lekë gjobë, dhe pezullim të aktivitetit për shfrytëzimin dhe fraksionimin e inerteve lumore pa leje mjedisore dhe në zonë të ndaluar nga Vendimi i K KU, nr 1, datë 21.06.2006 “Per reduktimin e shfrytëzimit të zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve”.

2. Xhihani, sh.p.k, Betim Xhihani 1 000 000 lekë gjobe, dhe pezullim të aktivitetit për fraksionimin e inerteve lumore pa leje mjedisore dhe në kundërshtim me Vendimin e K KU, nr 1, datë 21.06.2006 “Për reduktimin e shfrytëzimit të zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve”.

3. Albavia, sh.p.k, 2 000 000 lekë gjobë, dhe pezullim të aktivitetit për linjën e asfalto-betonit mbasi është pa leje mjedisore. Subjekti ka në impiant nje sasi te kosiderushme inertesh lumore dhe nuk u paraqiten fatuarat e origjines se zhavorit.

4. Sinameta , sh.p.k, 500 000 leke gjobe, per mosrespektimin e kushteve te lejes mjedisore per impiantin efraksionimit te inerteve lumore. Subjekti nuk ka fatura per origjinen e materialit te inerteve lumore.

5. Ilti sh.p.k, 2 000 000 leke gjobe, dhe pezullim te aktivitetit per shfrytezimin dhe fraksionimin e inerteve lumore pa leje mjedisore dhe ne zone te ndaluar nga Vendimi i K KU, nr 1, date 21.06.2006 “Per reduktimin e shfrytezimit te zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve”.

6. Bibax sh.p.k, 500 000 leke gjobe, per mosrespektimin e kushteve te lejes mjedisore per impiantin efraksionimit te inerteve lumore. Subjekti nuk ka fatura per origjinen e materialit te inerteve lumore.

7. Teuta Inerte , sh.p.k, 1 000 000 leke gjobe, dhe pezullim te aktivitetit per shfrytezimin dhe fraksionimin e inerteve lumore pa leje mjedisore dhe ne zone te ndaluar nga Vendimi i K KU, nr 1, date 21.06.2006 “Per reduktimin e shfrytezimit te zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve”.

8. Malo-2002 sh.p.k, 2 000 000 leke gjobe, dhe pezullim te aktivitetit per shfrytezimin dhe fraksionimin e inerteve lumore pa leje mjedisore dhe ne zone te ndaluar nga Vendimi i K KU, nr 1, date 21.06.2006 “Per reduktimin e shfrytezimit te zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve”.

9. Haxhi Kurti, person fizik 1 000 000 leke gjobe, dhe pezullim te aktivitetit per shfrytezimin dhe fraksionimin e inerteve lumore pa leje mjedisore dhe ne zone te ndaluar nga Vendimi i K KU, nr 1, date 21.06.2006 “Per reduktimin e shfrytezimit te zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve”.

- 10. Latif Hoxha**, person fizik 1 000 000 leke gjobe, dhe pezullim te aktivitetit per shfrytezimin dhe fraksionimin e inerteve lumore pa leje mjedisore dhe ne zone te ndaluar nga Vendimi i KKU, nr 1, date 21.06.2006 "Per reduktimin e shfrytezimit te zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve".
- 11. Mondi Rikes sh.p.k**, 2 000 000 leke gjobe, dhe pezullim te aktivitetit per shfrytezimin dhe fraksionimin e inerteve lumore pa leje mjedisore dhe ne zone te ndaluar nga Vendimi i KKU, nr 1, date 21.06.2006 "Per reduktimin e shfrytezimit te zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve".
- 12. Shkumbini sh.p.k**, 2 000 000 leke gjobe, dhe pezullim te aktivitetit per shfrytezimin dhe fraksionimin e inerteve lumore pa leje mjedisore dhe ne zone te ndaluar nga Vendimi i KKU, nr 1, date 21.06.2006 "Per reduktimin e shfrytezimit te zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve".
- 13. Haveriku sh.p.k**, 500 000 leke gjobe, per mosrespektimin e kushteve te lejes mjedisore per impiantin efraksionimit te inerteve lumore. Subjekti ka leje mjedisore per shfrytezim inertesh ne taraca lumore por nuk ka respektuar sasine e parashikuar ne lejen mjedisore dhe nuk ka derguar te dhenat e monitorimit ne ARM Kavaje.
- 14. Habili sh.p.k**, Subjekti ka leje mjedisore per shfrytezim inertesh ne taraca lumore por u la aktkontroll per te pare ne terren distancen prej 250 m nga bregu i lumit shkumbin te parashikuara ne lejen mjedisore . Verifikimi do te kryhet nga Inspektori i Mjedisit per kavajen dhe do te dergoje informacion ne Inspektoriatin e Mjedisit.
Kontrollet janë një nga objektivat kryesor të MMPAU-së për zbatimin e plotë të legjislacionit aktual mjedisor.